

20252444745

МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА, ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ

Në bazë të Nenit 107-e paragrafi (2) i Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 и 245/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23, 194/24, 75/25 dhe 154/25), Ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i të Rinjve, solli

R R E G U L L O R J A

PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E KËRKESËS PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR NGA I SIGURUARI I CILI KA QENË NË MARRËDHËNIE PUNE, PËRKATËSISHT NË PUNË NË BAZË TË SË CILËS ËSHTË REGJISTRUAR NË SIGURIMIN SHOQËROR TË DETYRUESHËM, DHE NGA ANA E OBLIGUESIT TATIMOR PËR LLOGARITJEN E KONTRIBUTIT NUK ËSHTË PAGUAR KONTRIBUTI PËR SIGURIMIN PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet forma dhe përmbajtja e kërkesës për pagesën e kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor nga personi i siguruar i cili ka qenë në marrëdhënie pune, përkatësisht në punë në bazë të së cilës është regjistruar në sigurimin shoqëror të detyrueshëm, dhe nga ana e obliguesit tatimor për llogaritjen dhe pagesën e kontributit nuk është paguar kontributi për sigurimin pensional dhe invalidor.

Neni 2

Kërkesa nga Neni 1 e kësaj rregulloreje duhet të dorëzohet në formularin BPP/PIO/1 - Kërkesë për pagesën e kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor, i cili është dhënë në Shtojcë dhe është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për pagesën e kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor nga personi i siguruar i cili ka qenë në marrëdhënie pune, përkatësisht në vend pune në bazë të së cilës është regjistruar në sigurimin e detyrueshëm shoqëror, dhe nga ana e obliguesit tatimor për llogaritjen dhe pagesën e kontributit nuk është paguar kontributi për sigurimin pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/20).

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e shpalljes së saj në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr.09-7836/3
1.12.2025
Shkup

Ministri i Politikës Sociale
Demografisë dhe i të Rinjve
Fatmir Limani d.v.

Shtojcë

Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor
i Maqedonisë së Veriut

Formulari BPP/PIO/1

Filiali/Zyra

KËRKESE

Për pagesë të kontributit për sigurimin pensional dhe invalidor

1. Të dhëna për aplikantin
1.1. Emri dhe mbiemri i të siguruarit
1.2. NVAQ i të siguruarit
1.3. Adresa e selisë/vendbanimi
Rruganumër.....
Komunavendi.....
Telefon
E-mail.....

2.1 Të dhëna rreth obliguesit tatimor tek i cili ishte i regjistruar për sigurimin shoqëror të detyrueshëm
Emri dhe selia e regjistruar e obliguesit tatimor:
NVAS ose NVT i obliguesit tatimor ose numri i regjistrimit i të siguruarit
.....
.....
.....
3. Të dhëna mbi periudhën e kontributit të papaguar për sigurimin pensional dhe invalidor
Ngaderi më.....
Nga..... deri më.....
Nga..... deri më.....
Data e depozitimit
Nënshkrimi i aplikantit
N.I.